

Nr. 2829 Prot.
Datë 14. 6. 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISEË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
SARANDË

Nr.Rregj.Them 00495/1112

Sarandë më dt 10.10.2025

Lënda: Mbi afishimin e kopjes së shpalljes

BASHKISË DELVINË

Bashkëngjitur po ju dërgojmë një kopje të shpalljes për njoftimin e të paditurin **Gentian Shameti**, banues në Delvinë, për seancën që do të zhvillohet në datë **19.11.2025, ora 11:15**.

Afishoni kopjen e shpalljes në një nga ambientet e dukshme pranë jush.

Lutemi te na vihet në dispozicion konfirmimi i shpalljes publike nga ana juaj!

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

GJYQTARE
EDONA VAJUSHI

2. Informacionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
SARANDË

Nr.Rregj.Them 00495/1112

Sarandë më dt 10.10.2025

SHPALLJE PUBLIKE PËR EFEKT NJOFTIMI
(Për njoftimin e të paditurin)

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, është regjistruar dhe po shqyrtohet çështja civile me nr. 00495/1112 regj.them që i përket:

Paditëse: Dhurata Shameti.
I paditur: Gentian Shameti
Objekti: Zgjidhje martese.

Në kushtet që njoftimi i të paditurin **Gentian Shameti** nuk është i mundur të realizohet në ndonjë mënyrë tjetër, bazuar në nenin 133/a dhe 133/b të K.Pr.Civile me këtë “shpallje publike” ai njoftohet se kundër tij është ngritur padia me objektin e sipërcituar dhe se seanca përgatitore do të zhvillohet në datë **19.11.2025**, ora **11:15** në ambientet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Ky njoftim qëndron i afishuar jo më pak se 20 ditë. Me kalimin e këtij afati njoftimi konsiderohet i kryer dhe gjykimi mund të vazhdojë në mungesë të të paditurit.

Kjo shpallje afishohet në stendën e njoftimeve e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, në vendbanimin e të paditurit, si dhe në njësinë administrative në të cilën ka vendbanimin i padituri.

Personi dhe/ose institucioni i ngarkuar për afishimin e kësaj shpallje, duhet të njoftoj gjykatën për datën e vendosjes në vendet përkatëse.

GJYQTARE

EDONA VAJUSHI

2009
Datë 16.10.2025



Informacioni
EZH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PERGJITHSHME E PERMBARIMIT
ZYRA E PERMBARIMIT SARANDE

Nr.456 Regj Nr1099Prot

Sarandë më,13.10.2025

VENDIM

Mbi

“Njoftimin me shpallje publike për palën debitore”

Unë **Blerta Zika** Përmbarues Gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Sarandë, pasi studiova aktet proceduriale të dosjes përmbarimore me ” Urdhër Ekzekutimi” **Nr. 40 Dt .04.02.2007** të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë

KONSTATOVA

Se është depozituar pranë Zyrës së Përmbarimit Sarandë kërkesa e kreditorit së bashku me “Urdhërin e Ekzekutimit” për Titullin Ekzekutiv (vendim penal) **Nr.25 Dt.19.01.2007** të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, me palë:

Kreditor : Buxheti i Shtetit

Debitor : Faik Kajo Rakipi

Objekt : Pagim shpenzime, taksë përmbarimore, tvsh mbi tarifë.

-Pasi janë kryer një sërë procedurash përmbarimore, pala debitore nuk ka marrë dijëni zyrtarisht asnjëherë nga komunikimi i akteve të kryera nga shërbimi postar ,pasi ka rezultuar se debitori është larguar.

-Zyra e Përmbarimit Sarandë për efekt njoftimi përserit njoftimin me shpallje për palën debitore **Faik Kajo Rakipi** ,një kopje e së cilës të afishohet pranë Bashkisë Delvinë,një kopje pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë dhe një kopje të administrohet në dosjen përmbarimore përkatëse.

-Ky njoftim nëpërmjet shpalljes behet sipas nenit 133/a,133/b, 44/a si dhe nenit 517 të K.të Procedurës Civile.

-Pas njoftimit me shpallje(me afat 20ditor),pala debitore quhet e njoftuar dhe Zyra e Përmbarimit do të vijojë me procedurat ligjore për ekzekutim te detyruar.

PËRMBARUES GJYQËSOR
Blerta ZIKA

